



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenin 65, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 03 prill 2017), dhe nenin 4, paragrafi 3, dhe nenin 34 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSAKSIONET ME PERSONAT E NDËRLIDHUR TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj parimet në rastet e transaksioneve që siguruesi i bën apo synon ti bëjë me palët e ndërlidhura me atë sigurues.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit e licencuar nga BQK. Për degët e siguruesve të jashtëm kjo rregullore aplikohet vetëm për menaxheret e lartë dhe punonjësit e tyre.

Neni 2

Definicionet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregullore:
 - 1.1. **Personat ose palët e ndërlidhura me siguruesit** – nënkupton çdo person që ka së paku njërin nga marrëdhëniet e mëposhtme me siguruesin:
 - 1.1.1. Menaxherët e lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve dhe aksionarët kryesorë të siguruesit, individët e ndërlidhur me menaxherët e lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve apo me aksionarët kryesorë të siguruesit;
 - 1.1.2. Personat juridikë në të cilët menaxherët e lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve apo aksionarët kryesorë të siguruesit janë po ashtu aksionarë kryesorë;
 - 1.1.3. Personat që kanë interes të konsiderueshëm në personin juridik ku siguruesi ose ndërmjetësuesi ka interes të konsiderueshëm;
 - 1.1.4. Filialet (subjektet e varura) të siguruesit.
 - 1.2. **Individë të ndërlidhur me siguruesin** – nënkuptohet:

- 1.2.1 Në lidhje gjaku: prindërit e një personi fizik, fëmijët, gjyshërit, vëllezërit, motrat, nipat dhe mbesat.
- 1.2.2 Në lidhje martese: bashkëshorti/ja e një personi fizik, prindërit e bashkëshort/it/es, vëllezërit, motrat si dhe nipat e mbesat e bashkëshort/it/es.
- 1.3. **Punonjës** – nënkupton çdo person, përveç personave të ndërlidhur me siguruesin i cili mban pozitë punësimi te siguruesi dhe merr kompensim për punët ose shërbimet e kryera.
- 1.4. **Transaksionet me palët e ndërlidhura** – i referohet, transaksioneve në mes siguruesit dhe një personi të ndërlidhur me atë sigurues.
- 1.5. **Vlerë ekonomike** – nënkupton vlerën që një person është i gatshëm të paguaj për një mall dhe/ose shërbim, e matur në njësi valutore.

Neni 3

Transaksionet me palët e ndërlidhura

1. Transaksionet me palë të ndërlidhura te siguruesit duhet te kryhen në përputhje me kushtet (vlerën) normale të tregut.
2. Një transaksion konsiderohet si i trajtuar me vlerë tregu nëse vlera e mallrave dhe/ose shërbimeve (përfshirë këtu konsulencën dhe të ngjashme) në transaksion:
 - 2.1 janë dhënë dhe paguar me vlerë tregu;
 - 2.2 do të ofrojë një vlerë ekonomike;
 - 2.3 korrespondon me vlerën të cilën marrësi i mallit dhe/ose shërbimit do të ishte i gatshëm të paguante për të tek një palë e pavarur; dhe
 - 2.4 korrespondon me vlerën për të cilën mund të dakordohen palët e pavarura.
3. Transaksionet e ndaluara me palë të ndërlidhura përfshijnë:
 - 3.1 investimet ose depozitat te palët e ndërlidhura kur me normat e kthimit janë me të ulëta se ato të tregut;
 - 3.2 huazimet tek palët e ndërlidhura;
 - 3.3 shitja e pasurive ose shërbimeve e palëve te ndërlidhura kur çmimi i shitjes është me i ulët se vlera e tregut;
 - 3.4 blerja e pasurive ose shërbimeve kur çmimi i blerjes është më i lartë se vlera e tregut;
 - 3.5 marrëveshjet me menaxhimin e mjeteve me palët e ndërlidhura, kur tarifat e menaxhimit janë më të larta se sa menaxhimi i mjeteve nga palët tjera;
 - 3.6 marrëveshjen e qirasë me palën e ndërlidhur, kur vlera e qirasë nuk paraqet vlerën e drejtë të tregut;
 - 3.7 ndërmarrjet e përbashkëta me palë të ndërlidhura, në rastet kur siguruesi bart pjesë të lartë të kostos dhe përfiton pjesë më të ulët të fitimeve;
 - 3.8 garancitë për palën e ndërlidhur pa aplikuar tarife ose duke aplikuar tarife më të ulët se tarifa e aplikuar për palët tjera.

Neni 4

Transaksionet me punonjësit e siguruesit dhe individëve të tyre të ndërlidhur

Transaksionet me punonjësit e siguruesit dhe individët e ndërlidhur të tyre duhet të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut. Përcaktimet nga paragrafi 2 i nenit 3 të kësaj rregullore aplikohen përshtatshëmrisht edhe për transaksionet me punonjësit e siguruesit.

Neni 5

Kufizimet në përdorimin e mjeteve në zotim

Siguruesi i cili i mbanë mjetet në zotim (si fiduciar) nuk mund të përdorë këto mjete apo një pjesë të tyre në ndonjë transaksion me palët e ndërlidhura, punonjësit e tyre si dhe individët e ndërlidhur me punonjësit e tyre.

Neni 6

Përgjegjësia e Bordit të Drejtorëve për transaksionet me palë të ndërlidhura

1. Bordi i drejtorëve të siguruesit është përgjegjës për hartimin e politikave të qarta mbi transaksionet me personat e ndërlidhur dhe konfliktin e interesit. Politika duhet të rishikohet në baza vjetore dhe çdo ndryshim i politikës duhet të aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve.
2. Bordi i drejtorëve të siguruesit mund të themelojë komitet të posaçëm për trajtimin dhe mbikëqyrjen e transaksioneve me palë të ndërlidhura dhe konfliktet e interesit.
3. Bordi i drejtorëve të siguruesit duhet të sigurohet që transaksionet me palë të ndërlidhura të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut.

Neni 7

Shpalosja e interesave të palëve të ndërlidhura

1. Palët e ndërlidhura me siguruesin të cilat kanë interes të drejtpërdrejt ose tërthorazi në një transaksion ose një transaksion të propozuar me siguruesin, duhet paraprakisht t'i shpalosin me shkrim bordit të drejtorëve ose komitetit të posaçëm për trajtimin dhe mbikëqyrjen e transaksioneve me palë të ndërlidhura dhe konfliktet e interesit nëse i njëjti është themeluar, natyrën dhe shtrirjen e interesave të palës së lidhur në transaksion. Në rastin kur pala e ndërlidhur është drejtor dhe/ose aksionar, shpalosja e informatave sipas këtij paragrafi duhet të bëhet në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve. Të gjitha shpalosjet e tilla të paraqitura në bord të drejtorëve/asamble të përgjithshme të aksionarëve duhet të regjistrohen në procesverbalet e mbledhjeve përkatëse.
2. Të gjitha shpalosjet e kërkuara me palët e ndërlidhura sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të bëhen si më poshtë:
 - 2.1. Në mbledhjen më të afërt të bordit të drejtorëve të siguruesit/asamblesë së përgjithshme të aksionarëve pasi çështja që kërkon shpalosje është e njohur për palën e ndërlidhur.
 - 2.2. Në rastet kur personi i cili është i interesuar në transaksion apo ka hyre në transaksion më herët me siguruesin, më vonë bëhet palë e ndërlidhur me siguruesin, ai person duhet të bëj

shpalosjen në mbledhjen më të afërt të bordit të drejtorëve/asamblesë së përgjithshme të aksionarëve pasi ai të jetë bërë palë e ndërlidhur.

3. Pala e ndërlidhur për të cilën kërkohet ta bëj shpalosjen e interesave sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nuk duhet:
 - 3.1. të merr pjesë në vlerësim, diskutim apo të votoj në ndonjë vendim për miratimin apo refuzimin e transaksionit në lidhje me të cilin është kërkuar shpalosja;
 - 3.2. të jetë prezent në takime apo mbledhje të bordit të drejtorëve/asamblesë së përgjithshme të aksionarëve derisa bordi/asambleja të merret apo të diskutoj mbi çështjen e transaksionit për të cilin është kërkuar shpalosja;
 - 3.3. të ndikoj apo të tentoj të ndikoj në vlerësimin apo votimin e vendimin për miratimin apo refuzimin e transaksionit për të cilin është kërkuar shpalosja.

Neni 8

Raportimi i transaksioneve me persona të ndërlidhur, në BQK

Siguruesit duhet të raportojnë transaksionet me persona të ndërlidhur në baza vjetore në BQK, deri me datë 31 janar të vitit vijues për vitin pasues, sipas shtojcës 1 të kësaj rregullore.

Neni 9

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Shkelja e dispozitave të kësaj rregullore, do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 05/L-045 për sigurimet.

Neni 10

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore do të shfuqizohet Rregulli 27 mbi Transaksionet me Palët e Afërta të datës 28 mars 2002.

Neni 11

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është Shtojca 1 e bashkangjitur.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca 1 – Shpalosjet e transaksioneve me palë të ndërlidhura

Emri i Siguruesit:

Viti:

Periudha (DD/MM):

| Palët e ndërlidhura | Numri identifikues | Adresa | Marrëdhënia e palës së ndërlidhur me siguruesin |
|---------------------|--------------------|--------|---|
| 1. | | | |
| 2. | | | |
| 3. | | | |
| 4. | | | |
| 5. | | | |
| 6. | | | |

| Transaksionet me palët e ndërlidhura, gjatë periudhës raportuese | | | | |
|--|----------------------------|------------|--------------------|-----------------------------|
| Personat e ndërlidhur | Përshkrimi i transaksionit | Shuma në € | Termet dhe kushtet | Outputi/rezultati i pranuar |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

| Gjendja në fund të periudhës, me palët e ndërlidhura | | | |
|--|--------------------------------|------------|--------------------|
| Personat e ndërlidhur | Lloji i gjendjes përfundimtare | Shuma në € | Termet dhe kushtet |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | | |
|--|--|--|--|

| Kompensimet për drejtorët dhe menaxherët e lartë | | | |
|---|-----------------------------------|-------------------|---------------------------|
| Emri dhe mbiemri | Përshkrimi i transaksionit | Shuma në € | Termet dhe kushtet |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

| Detyrimet kontigjente | | | |
|------------------------------|--|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

| Shpjegime tjera |
|------------------------|
| |

Vendi, data:

Përgatitur nga (emër, mbiemër):

Nënshkrimi:

Personi përgjegjës (emër, mbiemër):

Nënshkrimi dhe vula:

| |
|--|
| |
| |
| |
| |
| |